



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e martë, datë 25.02.2025, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Armela	KRASNIQI	Kryetar
Desada	METAJ	Zëvendëskryetar
Aurela	BICJA	Anëtar
Besian	ZOGAJ	Anëtar
Gjergji	HAMITI	Anëtar
Jetmir	HALILAJ	Anëtar
Joana	ALLUSHI	Anëtar

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Konstatimin e pavlefshmërisë së autorizimit të shoqërisë “Teleco” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve online, mbështetur në rrjet (IP) OTT “Teleco”. **(Vendim nr. 16, datë 25.02.2025)**
2. Refuzimin e ankimit administrativ dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 3 datë 09.01.2025 për dënimin me gjobë, të subjektit person fizik Dritan Memushi, autorizuar për subjektin OSHMA “Tv me kabëll Tepelena Sat”. **(Vendim nr. 17, datë 25.02.2025)**
3. Dhënien e autorizimit shoqërisë “FRI MEDIA” sh.p.k., për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv online, mbështetur në rrjet IP (OTT) “DRITA TV”. **(Vendim nr. 18, datë 25.02.2025)**

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 25 Shkurt 2025